



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr** \_\_\_\_\_

**Dt: 09.03.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Klubit të Boksit “Sport Center” nga Gjakova, me dt: 09.03.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Klubit të Boksit “Sport Center” nga Gjakova nr. 10-400-16239 e dt: 26.02.2015, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi për mbarëvajtjen e garave në kampionatin 2014/2015, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 1,000.00 € .

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Boksit “Sport Center” nga Gjakova nr. 1306001002127158 - BPB

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**CO:** - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport  
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa  
- Klubit të Boksit “Sport Center” nga Gjakova  
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**